

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGES AUTOMOBILISTIKE “Qender KOMUNE – ROSUJE – LEKURTAJ - SELIMAJ”

PERSHKRIMI I RRUGES EKZISTUESE.

Ky segment rrugor eshte pjese e rruges qe lidh Qendren e Komunes Bujan (Fshati Dojan) me 4 fshatra te kesaj Komune, Rosuje, Gri , Lekurtaj e Selimaj dhe fillon 1.7 km nga qendra e Komunes dhe perfundon ne fshatin Selimaj (tek Xhamia e ketij fshati).

Gjatesia e pergjitheshme e rruges eshte 6800 m

Kuota e fillimit te rruges eshte rreth 314 m dhe perfundimi rreth 554 m. Kuota me e larte eshte 572 m ne Fshatin Selimaj (Pg.5273 m) dhe ajo me ulet te ish Mulliri i Doshlanit,302 m (Pg.238 m).Kuota eshte absolute, e marre nga harta e zones, ne menyre qe te kete perputhje me projektin e segmentit paraardhes Dojan-Bllate-Rosuje.

Ky segment rrugor eshte ndertuar ne vitet 1970 , si rruge per shfrytezimin e masivit te geshtenjave dhe eshte ne gjendje mjaft te keqe, pa shtresa, pa vepra arti, me pjerresi gjatesore deri ne 18 % dhe ne disa segmente i pakalueshem nga automjetet.Perjashtim ben segmenti prej 2 km nga Qendra e fshatit Lekurtaj deri ne Selimaj, i rikonstruktuar para 7 vitesh me nje gjeresi kalimi prej rreth 3m me shtresa rrugore prej çakulli e zhavorri, por te demtuara ne nje mase te konsiderueshme dhe me veprat e artit (8 tombino dhe nje ure me HD=6 m si dhe disa mure mbajtes e prites) ne gjendje pergjithesist te mire.

Gjeresia e rruges ekzistuese rreth 2.5 deri ne 3 m, e pamjaftueshme per realizimin e punimeve sipas kerkesave teknike.Pjerresia maksimale eshte 18% ne disa segmente prej rreth 1000 m , ndersa pjesa tjeter ka nje pjerresi te pranueshme.

Kanalet kulluese anesore mungojne krejtesisht.

Per te bere te mundur levizjen normale ne kete rruge, sipas kerkeses se Komunes Bujan , eshte e domosdoshme te nderhyhet ne kete segment per te bere sistemimin dhe asfaltimin e tij.

Pasi u bene matjet e nevojeshme ne terren, grupi i projektimit ka hartuar projekt-zbatimin per sistemim-asfaltimin e segmentit rrugor “Qender Komune-Rosuje-Lekurtaj-Selimaj”.

PROJEKT – ZBATIMI

Projekt-zbatimi i kesaj rruge eshte hartuar ne perputhje me kerkesat e detyres se projektimit dhe standarteve teknike perkatese per rruget lokale, duke ju permbajtur zbatimit te ketyre parametrave kryesore:

- shpejtesia e projektimit rreth 30 km/ore
- rrezja minimale e kthesave 15m
- pjerresia maksimale gjatesore 12%
- gjeresia e trupit te rruges (4m+0.50m bankine+0.70m kunete me borduren)

-te parashikohen vendet e nderrimit ne funksion te terrenit

Duke u nisur nga pershkrimi i gjendjes ekzistuese te rruges ne baze te matjeve topografike ne terren, zhvillimit planimetrik te rruges “Qender Komune-Rosuje-Lekurtaj-Selimaj”, i jane bere permiresimet e duhura vetem ne zonat ku rrezet e gjurmes ekzistuese kane qene me pak se 15m, ndersa permiresimet ne altimetri jane te shumta, pasi sic kemi theksuar rruga nuk ka patur nje nivelete normale per vete karakterin e perdorimit te saj ne kohen e ndertimit.

Ne pergjithsi permiresimet altimetrike jane realizuar ne menyre te tille qe te eliminohen pjerresite mbi 14 %, pasi ne disa zona nuk mund te operohej me pjerresi me te vogla, vetem po te devijohet teresisht traseja ekzistuese gje e cila nuk mund te realizohet pa kosto te medha financiare sidomos me shpronesime.

Permiresimi i niveletes eshte bere ne zonat me pjerresi te madhe (rreth 1000 m gjithsej), duke e ulur ate ne 14% (Sek.6 deri Sek.10 ; Sek.20 deri Sek.32; Sek.52deri Sek.56 dhe nga Sek.120 deri Sek.131).

Permiresimet e tjera altimetrike ne pjesen tjetere jane te karakterit te vogel duke rregulluar ne pergjithesi gungat ekzistuese dhe duke realizuar nje rrjedhshmeri ne drejtimin gjatesor.

Rruga ekzistuese (deri ne Pg.4800) sic e kemi permendur edhe me siper,nuk ka shtresa (vetem dheu sic ka mbetur pas hapjes se trasese), ndersa pjesa tjetere prej 2 km, ka nje bazament qe perbehet nga nje shtrese zhavorri prej rreth 30cm mbi te cilen ka nje shtrese cakulli 15-20 cm,i cili ka sherbyer si shtrese konsumuese dhe ne pergjithesi kjo eshte e demtuar.

Per vete rendesine qe ka kjo rruge si drejtimi i vetem i lidhjes se Zones se Grise dhe Geghysenit me qendren e Komunes dhe me qendrat e Rrethit e te Qarkut, del e nevojshme te behet asfaltimi i saj.

Projekti parashikon ndertimin e te gjitha shtresave rrugore ne segmentin prej 4800 m (deri ne qender te fshatit Lekurtaj) si dhe germimin e shtreses se demtuar te cakullit dhe zevendesimin e saj me nje shtrese te re prej 30 cm dhe ndertimin e shtresave te stabilizantit, binderit e asfaltobetonit, ne gjithesiperfaqen e rruges ekzistuese nga Pg.4800 deri ne Pg.6800, si dhe zgjerimin e trupit te rruges per arritjen e gjereses se kerkuar prej 5.4 m (4m pjesa kaluese+0.5m bankina+0.7 m kuneta).

Pas germimeve dhe mbushjeve perkatese,sipas profilave terthore e gjatesore,fillon nderimi i shtresave rrugore si vijon:

- Shtrese gur gurore 40 cm**
- Shtrese cakelli 20 cm**
- Stabilizant 10 cm**
- Binder 5 cm**
- Asfaltobeton 3 cm (Tapeti)**

ndersa ne segmentin prej 2 km (Lekurtaj-Selimaj),behet zgjerimi i trupit te rruges me germimet perkatese dhe ne pjesen e zgjeruar ndertohet kasoneta ne nje gjeresi nga 0.8-1.5 m duke e mbushur me nje shtrese 30 cm cakulli (zhavorri).

Pas ketij procesi hidhen shtresat rrugore si vijon:

- Stabilizant 10 cm**
- Binder 5 cm**
- Asfaltobeton 3 cm (Tapeti)**

Do te ndertohen te reja gjithsej 22 tombino, nga te cilat 5 cope $\varphi=1000$, 11 cope $\varphi=800$ dhe 6 tombino $\varphi=600$ si dhe do te zgjaten dhe ndertohen puseta apo potali (si ne profilet terthore perkatese) 6 tombino ekzistuese.

Ura ekzistuese eshte ne gjendje te mire dhe nuk ka nevojte per nderhyrje.

Ne gjithe gjatesine e rruges do te ndertohet bankina prej 50 cm dhe kuneta prej 70 cm (40 cm+30 cm bordura) ne krahuin tjetër.

Ne disa zona ku pjerresia terthore e terrenit eshte shume e madhe, do te ndertohen mure betoni M-200 (mbajtese dhe pritese), sipas rastit te pasqyruara ne seksionet terthore, me lartesi qe variojne nga H=2m deri ne H=4.5m, me nje gjatesi totale L=940 m nga te cilat Mure Mbjatese 707 m dhe Mure Pritese 233 m.

Ne nje zone prej 140 m ne vendin e quajtur Shkalla e Grise (Sek.97 deri ne Sek.104) terreni eshte shkembor dhe teper i aksidentuar me nje rruge kalimi shume te ngushte, prandaj ketu eshte parashikuar rruga me pjerresi te njeaneshme dhe pa bankine e shoqeruar me mur mbajtes ne anen e poshtme dhe nje bordure mbrojtese ne krahuin e djathte.

Jane parashikuar vendnderrime ne çdo 300-400 m, gjithsej 19 te tilla.

Edhe futjet ne zonat e fshatrave, rruget dytesore jane trajtuar ne nje gjatesi 4m duke i asfaltuar ato.

Ne rastet e kryqezimeve me rruget dytesore ne krahuin e djathte te rruges, kemi vendosjen e tubave $\varphi=300$ (çeliku) si vazhdim i kunetes.

Ne te njëjtën kohe sigurimi i kushteve optimale për qarkullimin rrugor te mjeteve kërkon sinjalistikën përkatëse. Preventivi parashikon si vijëzimin e rrugës ashtu edhe vendosjen e tabelave orientuese, ndaluese dhe paralajmëruese ne përputhje me kodin rrugor ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë.

Duke patur parasysh terrenin, jane parashikuar ne projekt te ndertohen 886 ml guardraile (mbrojtese metalike) ne zonat ku ka mure mbajtese dhe tombino, te paraqitura ne seksionet terthore per secilin rast.

Ne preventiv është parashikuar edhe fondi 5% si rezerve për punime qe nuk mund te parashikoheshin gjate projektimit te veprës dhe qe mund te rezultojnë gjate zbatimit te saj. Ky fond do te përdoret ne përputhje me ligjet dhe udhëzimet për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndërtimit ne fuqi.

Çmimet njësi te vendosura janë ato te percaktuara ne Manualin nr.3 te analizave te çmimeve te ndërtimit.

Preventivi ka parashikuar gjithashtu kostot për drejtimin dhe kolaudimin e punimeve te veprës ne baze te (V.K.M Nr.444, dt.05.09.94).

Vlefte e plote e projekt-preventivit eshte 144 310 773 leke, (me TVSH=173 172 928 leke).

Për çdo sqarim ose paqartësi tekniko-ekonomike ne lidhje me zbatimin e veprës, projektuesi do te ofroje asistencën e vet gjate zbatimit te saj nëse do te jete e nevojshme.

Tirane, Mars 2012

Per Shoqërinë: "S.P.TECHNIC" Sh.p.k

Ing.Sadri Isufi

Ing.Sokol Metoja

